



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Seanca plenare  
Nr. 02-48/09-07  
Prishtinë, më 30 mars 2007, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Në fillim seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë, kurse më vonë e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit.

**Kryesuesi** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 72 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve dhe i transkripteve të seancave plenare të 14, 16 dhe 22 marsit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Interpelanca e ministrit të Ekonomisë dhe Financave, z. Haki Shatri, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bletarinë dhe
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Gjqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me Projektligjin për ditën e dëshmorëve.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Deputeti **Ramadan Kelmendi** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet, si çështje e ngutshme, edhe çështja e ndërtimit të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës.

Deputetja **Teutë Hadri** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet, si çështje e ngutshme, edhe për çështjet në shëndetësi.

Deputeti **Lulzim Zeneli** kërkoi që Kuvendi i Kosovës ta nxjerrë një deklaratë përmes së cilës shpreh qëndrimin e tij për propozimin e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Matti Ahtisaari, për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Deputeti **Xhevat Bislimi** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet, si çështje e ngutshme, edhe ngritjen e çmimeve të energjisë elektrike.

**Alush Gashi**, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se çështjet e ngritura nga parafolësit e tij duhet të parashtrohen në procedurë të rregullt parlamentare. Ai e mbështeti kërkesën e Qeverisë së Kosovës që Projektligji për Ditën e Dëshmorëve t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

**Jakup Krasniqi**, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, - tha se para se të diskutohet për çështjet e ngritura duhet pasur një informatë me shkrim nga Qeveria e Kosovës, kurse për propozimin e ish-presidentit Matti Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës Kuvendi duhet të mbajë një seancë të veçantë.

**Ferid Agani** në emër të Grupit Parlamentar për Integrim - tha se për të diskutuar çështjet e ngritura duhet pasur informata me shkrim nga Qeveria e Kosovës. Për propozimin e ish-presidentit Matti Ahtisaari për zgjidhjen e statusit të Kosovës Kuvendi duhet të mbajë një seancë të veçantë. Ai i informoi deputetë e Kuvendit se Grupit Parlamentar për Integrim i është bashkangjitur deputetja **Vezira Emrush** në vend të ish-deputetit Rrustem Ibishi.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi, **Xhavit Haliti**, konstatoi: Të gjitha çështjet e ngritura për t'i shqyrtuar në seancën e sotme duhen të parashtrohen në mënyrë të rregullt përmes Zyrës për Parashtrës.

Kuvendi miratoi kërkesën e Qeverisë për ta tërhequr Projektligjin për Ditën e Dëshmorëve dhe për ta ripunuar.

## 2. Miratimi i procesverbaleve dhe i transkripteve të seancave plenare të 14, 16 dhe 22 marsit 2007

Procesverbalet e seancave plenare të 16 dhe 22 marsit u miratuan pa vërejtje.